


KOSOVA DHE ZGJEDHJET

ÇFARË MUND TË PËRMIRËSOHET?



Raport

KOSOVA DHE ZGJEDHJET: ÇFARË MUND TË PËRMIRËSOHET?

Ky raport është mbështetur nga:

Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe nga Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe i menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

Dhe

Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë



Norwegian Embassy

Deklaratë mohimi: Pikëpamjet dhe analizat në këtë raport politik janë vetëm të Grupit për Ballkan dhe Institutit për Politika Zhvillimore dhe nuk reflektojnë qëndrimet e donatorëve.

Autor: Grupi për Ballkan dhe Instituti për Politika Zhvillimore

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	2
Hyrje.....	3
Zgjedhjet dhe sistemi politik i Kosovës	4
Prapavija e zgjedhjeve të parakohshme	5
Baza institucionale	8
Zgjedhjet dhe administrimi i tyre.....	8
Votat e pavlefshme - Edukimi i votuesve.....	10
Votat me kusht.....	12
Votat me postë.....	13
Administrimi i rezultatit të zgjedhjeve.....	17
Kandidatët dhe subjektet	18
Përfundimet dhe Rekomandimet.....	19

Lista e Tabelave dhe Figurave

Figura 1. Statistika të përgjithshme të zgjedhjeve. Burimi: KQZ.....	9
Tabela 1. Statistikat e Zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës.....	10
Tabela 2. Statistikat e Zgjedhjeve Lokale	1
Tabela 3. Statistikat e Zgjedhjeve të të dyja niveleve.....	12
Tabela 4. Votat me kusht në zgjedhjet nacionale të vitit 2017	13
Tabela 5. Votat me kusht në zgjedhjet lokale të vitit 2017.....	13
Tabela 6. Votat me kusht në zgjedhjet për Kryetar Komune e të vitit 2017	14
Tabela 7. Votat me postë për zgjedhjet nacionale 2017	15
Tabela 8. Votat me postë për Kryetar Komune 2017.....	15

Përmbledhje ekzekutive

Reforma zgjedhore në Kosovë është diskutuar për një kohë të gjatë, si nevojë e pashmangshme nga faktorët politikë ndërkombëtarë dhe ata vendorë. Bashkimi Evropian vazhdimisht ka insistuar në hartimin e një reforme zgjedhore e cila do të sigurote “implementimin e praktikave më të mira” evropiane. Komisioni Evropian konsideron se është i nevojshëm vullneti politik i gjithë spektrit politik për ndërmarrjen e reformave të nevojshme zgjedhore, para raundit tjetër të zgjedhjeve të përgjithshme.¹ Megjithëkëtë, pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme, që nga viti 2011, Kosova hyri në zgjedhjet e parakohshme në vitin 2017 pa reformë zgjedhore. Ndonëse zgjedhjet nacionale dhe lokale të vitit 2017 u vlerësuan si të mira, pati disa mangësi gjatë administrimit të zgjedhjeve, të cilat zbehën suksesin tyre, si p.sh numri i madh i votave të pavlefshme, rinumërimi i pjesshëm i kutive të votimit që solli ndërrimin e rezultateve, certifikimi i vonuar i rezultateve përfundimtare, etj.

Mungesa e unitetit politik, përkatësisht e një konsensusi në disa prej aspekteve të sistemit zgjedhor, si p.sh për atë nëse listat e kandidatëve duhen qenë të hapura, nëse duhet ekzistuar një ose shumë zona zgjedhore, nëse mandati i KQZ-së, Ligji Zgjedhor etj., pamundësoi adresimin e disa çështjeve lehtësisht të qasshme të cilat, në rast të mbajtjes së zgjedhjeve, do të kontribuonin drejtpërsëdrejti në një proces zgjedhor më të mirë dhe më kredibil. Këto amandamentime nuk kërkojnë domosdoshmërisht reformimin e gjithë sistemit zgjedhor. Ky punim ka për qëllim adresimin e disa aspekteve të sistemit zgjedhor, për të cilat konsensusi ndërmjet faktorëve relevantë do të arrihej lehtë. Nëse këto aspekte do të përmirësoheshin, procesi zgjedhor do të rezultonte më i suksesshëm dhe nuk do të humbej kohë derisa Kosova të arrijë konsensusin e gjerë politik mbi reformën zgjedhore, e cila do t'i adresonte të gjitha çështjet diskutabile. Gjëja kryesore në procesin zgjedhor të një vendi është pikërisht siguria, të cilën duhet ta ketë një qytetar, se vota e tij, përkatësisht përmbushja e obligimit si qytetar i atij vendi, do të delegohet paanshëm. Për këtë arsye, duke qenë të vetëdijshëm për problemet kryesore të sistemit, mungesa e konsensusit mbi elementet kyçe të reformës zgjedhore nuk duhet të jetë pengesë për përmirësimin e sistemit për një qasje nga poshtë-lart.

Në bazë të hulumtimit dhe analizimit të të dhënave të proceseve zgjedhore të organizuara deri më tani në Kosovë, punimi sjell disa të gjetura, të cilat shtjellohen detajisht dhe ofron alternativa për përmirësimin e procesit zgjedhor. Aspektet kryesore të trajtuara të procesit zgjedhor, mes tjerash, janë:

- Nevoja për edukimin e votuesve për ushtrimin e të drejtës së tyre
- Administrimi i rezultatit të zgjedhjeve
 - Nevoja e rinumërimin të menjëhershëm të të gjitha kutive të votimit
 - Votat me kusht dhe me postë
 - Publikimi i votuesve, si nxitje për pastrimin e listës zgjedhore

¹Komisioni Evropian, (2018), Raporti për Kosovën – 2018, Kriteri Politik dhe Sundimi i Ligjit, Zgjedhjet, faqe 5, Bruksel, i qasshëm në <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-kosovo-report.pdf>(qasurnë korrik, 2018).

Përkundër ekzistimit të problemeve të shumta që duhen adresuar dhe diskutuar vazhdimisht, punimi i qaset reformës zgjedhore nëpërmjet çështjeve, me ndryshimin dhe përmirësimin e të cilave mund të arrihet lehtë një konsensus. Në këtë mënyrë, i githë procesi i reformës zgjedhore nuk do të bllokohej shkak i mosarritjes së konsensusit të gjerë mbi aspektet më diskutabile të sistemit zgjedhor. Punimi propozon ndërmarrjen e disa masave, që për synim fillestar kanë arritjen e një procesi të vazhdueshëm për përmirësimin e procesit zgjedhor, duke kontribuar kështu që edhe vullneti i qytetarëve të delegohet në mënyrë adekuate.

Hyrje

Zgjedhjet e parakohshme të 11 qershorit 2017, dhe zgjedhjet lokale të 22 tetorit, u karakterizuan me një mjedis politik të tensionuar, një sistem zgjedhor të pareformuar dhe me një realitet të ri kushtetues falë vendimeve të mëhershme në Gjykatën Kushtetuese. Për muaj e vite të tëra, Kuvendi i Kosovës nuk arriti të ratifikojë marrëveshjen e shënjimit të vijës kufitare mes Kosovës dhe Malit të Zi. Meqë ky ishte njëri prej dy kritereve të vetme të mbetur për liberalizimin e vizave, Kosova vazhdon të mbetet e izoluar dhe pa mundësi të lëvizjes së lirë. Nga ana tjetër, kjo temë dhe temat e tjera, si dialogu me Serbinë, themelimi i ushtrisë së Kosovës, asociacionit të komunave me shumicë serbe, lufta kundër korrupsionit etj., i gjetën partitë politike më të ndara se kurrënjëherë më parë.

Gjithashtu, Kosova në këto zgjedhje hyri me një sistem të pareformuar zgjedhor, megjithëse ka vite që flitej dhe punohej në të. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, organizatat e shoqërisë civile dhe mekanizmat e tjerë kërkonin vazhdimisht realizimin e reformës zgjedhore. Megjithkëtë, shpallja e zgjedhjeve të parakohshme nuk la mundësi që Kosova ta realizojë këtë reformë. Mungesa e reformës zgjedhore rezultoi me pengesa, para, gjatë dhe pas ditës së zgjedhjeve.

Edhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese të vitit 2014, pak para këtyre zgjedhjeve, me gjasë ndikuan në vendimin e partive politike për shpalljen e kandidatit për kryeministër. Partitë politike u treguan të vullnetshme për të krijimin e koalicioneve parazgjedhore dhe në synimin që të dalin të parat. Po ashtu, në zgjedhje pamë edhe një vullnet të partive politike për maksimizimin e votës së tyre, madje edhe përmes kandidimit të kryetarëve të komunave për deputetë.

Përkundër kësaj, përgjithësisht, në shumicën e vendeve në Kosovë zgjedhjet parlamentare dhe lokale ishin konkurruese dhe të administruara mirë.² Rrjedhimisht, nga njëra anë, vazhdojmë të kemi vlerësime se reforma zgjedhore është e domosdoshme dhe se çfarëdo procesi zgjedhor në të ardhmen duhet t'i paraprijë një reformë e tillë, dhe nga ana tjetër vlerësimi për dy palë zgjedhjet e fundit përgjithësisht është i mirë. Sido që të jetë, vetë procesi zgjedhor u karakterizua me parregullësi të izoluar dhe, përgjithësisht, pati pakënaqësi me mënyrën e administrimit të rezultatit zgjedhor, votave me postë, ndërveprimin institucional, etj.

Që nga viti 2011 përpjekjet për reforma në Kosovë ishin të vazhdueshme. Bashkimi Evropian insistonte vazhdimisht në hartimin e një reforme zgjedhore, e cila do të siguronte “implementimin e praktikave më të mira” evropiane. Para raundit tjetër të zgjedhjeve të përgjithshme është i

²Komisioni Evropian, (2018), Raporti për Kosovën – 2018, Kriteri Politik dhe Sundimi i Ligjit, Zgjedhjet, faqe 5, Bruksel, i qasshëm në <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-kosovo-report.pdf> (qasur në korrik, 2018).

domosdoshëm një vullnet politik i gjithë spektrit politik për ndërmarrjen e reformave të nevojshme zgjedhore. Kuvendi duhet t'i adresojë urgjentisht dobësitë, duke marrë në konsideratë rekomandimet e misionit vëzhgues të zgjedhjeve të BE-së. Rekomandimet e BE-së përfshijnë:

- Vendosja e një kohëzgjatjeje minimale për organizimin e zgjedhjeve të parakohshme
- Ndryshimi i ligjit, në mënyrë që ai të mundësojë një funksionim më të mirë të Qendrës së Rezultateve dhe Numërimit
 - Qartësimi i afatit të ankesave
 - Rritja e informimit të votuesve, etj.³

Ky punim ekzaminon zgjedhjet e fundit nga një perspektivë e përgjithshme e zhvillimit të sistemit demokratik, në njërën anë, dhe sistemin politik e partiak, nga ana tjetër. Në fillim është ofruar prapavija e organizimit të zgjedhjeve dhe sistemit politik, sfidat dhe ajo që e ka karakterizuar atë më së shumti. Tutje, punimi diskupon lidhur me mbarëvajtjen e përgjithshme të zgjedhjeve, përfshirë problemet ligjore, informimin e qytetarëve etj., pastaj problemet e administrimit të rezultatit zgjedhor, etj. Të gjitha këto, duke iu përmbajtur parimeve të një hulumtimi të pavarur dhe duke respektuar rregullat e shkrimit për politikat publike.

Një kapitull i veçantë i është kushtuar kandidatëve në zgjedhjet parlamentare. Më specifikisht, punimi trajton kandidimin e kryetarëve aktual të komunave në zgjedhjet parlamentare. Vëmendje i është kushtuar edhe faktit nëse ekziston baza ligjore dhe/ose legjitime për ndalimin e kandidimit të kryetarëve të komunave për deputetë, dhe anasjelltas. Në fund, jepen disa përfundime dhe listohen rekomandimet. Punimi është pjesë e programit të INDEP për qeverisje demokratike, dhe synon që përmes të gjeturave të tij të kontribuojë në përmirësimin e sistemit zgjedhor dhe trupave institucionale që e administrojnë atë.

Zgjedhjet dhe sistemi politik i Kosovës

Republika e Kosovës është demokraci parlamentare e përcaktuar me nenin 4 të Kushtetutës. Kosova është Republikë demokratike, e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit mes tyre, sikurse që është përcaktuar me këtë Kushtetutë.⁴ Parimi i Republikës parlamentare dhe i shtetit unitar konsiston në faktin se ekziston një organ përfaqësues, i cili ka pushtet ligjvënës në nivel nacional.

Komunat, nga ana tjetër, janë njësi qeverisëse të nivelit të dytë të qeverisjes, e që është pushteti lokal. E drejta e vetëqeverisjes lokale garantohet dhe rregullohet me ligj. Vetëqeverisja lokale ushtrohet nëpërmjet organeve përfaqësuese, të zgjedhura në zgjedhje të përgjithshme, të barabarta, të lira e të drejtpërdrejta, të zgjedhura me votim të fshehtë. Modeli i qeverisjes lokale dhe i organizimit territorial të Kosovës, bazohet kryesisht në parimin e devoluimit, që nënkupton vendosjen e një sistemi të vetëqeverisjes lokale që bart kompetenca, të cilat, sipas sistemit tradicional të organizimit shtetëror, ushtrohen nga organet e pushtetit qendror.⁵

³Misioni Vëzhgues i Bashkimit Evropian, (2017), Raporti Final i Zgjedhjeve të Përgjithshme të Kosovës të vitit 2017, i qasshëm në https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/final_report_eom_kosovo_june_2017.pdf (qasur në korrik, 2018)

⁴Kushtetuta e Republikës së Kosovës, (2008), Neni 4, Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushteteve, Prishtinë: GZRKS

⁵ Ibid, Neni 123.

Një model i tillë, i bazuar në ndarjen e qartë mes të pushtetit qendror dhe atij lokal, është vënë në funksion të zgjerimit të të drejtave të njeriut dhe decentralizimit të vendimmarrjes, shërbimeve dhe pushtetit në përgjithësi.⁶ Për më tepër, karakteri unitar i qeverisjes ka bërë që për zgjedhjet nacionale zakonisht të flasim si për një sistem me një zonë zgjedhore, ngase vendimmarrja në organin(et) e zgjedhur vlenë për tërë territorin, përgjithësisht.

Njëkohësisht, procesi i decentralizimit të pushtetit dhe i krijimit të komunave të reja sipas Pakos së Ahtisarit determinoi edhe zgjedhjen e drejtëpërdrejtë të kryetarve të komunave, për shkak se me reformën e sistemit politik që po ndodhte, tek të njëjtit ishte koncentruar një pjesë e madhe e pushtetit. Kështu, sistemi aktual zgjedhor është pjesërisht i përcaktuar nga forma e qeverisjes dhe nga historiku i shtetndërtimit të Republikës së Kosovës.

Prapavija e zgjedhjeve të parakohshme

Në seancën e 6 qershorit 2008, ishin miratuar dy ligje thelbësore për sistemin zgjedhor të Republikës së Kosovës; Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligji për Zgjedhjet Lokale. I pari u miratua me vetëm 64 vota pro, ndërkaq i dyti me 79 vota pro, me asnjë kundër dhe me asnjë abstenim.⁷ Kështu, për një ditë në lexim të dytë u miratuan dy ligje, të cilat paraprakisht u diskutuan gjerë e gjatë. Dilemat kryesore ishin rreth përmbajtjes së Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Në fillim të majit, në kryesinë e Kuvendit të Republikës së Kosovës u deponua kërkesa e 41 deputetëve për mocion mosbesimi ndaj Qeverisë Mustafa. Deputetët shfrytëzuan nenin 100 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përkatësisht pikën 1 të tij: mocioni i mosbesimit ndaj Qeverisë mund të ngrihet me propozimin e një të tretës (1/3) së të gjithë deputetëve të Kuvendit.⁸ Kryesia e Kuvendit menjëherë caktoi datën 10 maj për mbajtjen e seancës plenare, në të cilën do të shqyrtohej dhe votohej mocioni i mosbesimit.

Zgjedhjet e parakohshme erdhën si rezultat i dekretit për shpërndarjen e Kuvendit pas mocionit të suksesshëm të mosbesimit ndaj Qeverisë. Votimi për mocion mosbesimi ishte e gjerë, sepse 78 deputetë votuan pro, përfshirë deputetët e komuniteteve.⁹ Në të njëjtën ditë, Presidenti i Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, shpalli dekretin për shpërndarjen e Kuvendit, bazuar në votën e suksesshme të mosbesimit për Qeverinë.¹⁰ Me këtë dekret iu hap rruga organizimit të zgjedhjeve të parakohshme 2017, si zgjedhje të treta të përgjithshme që nga shpallja e pavarësisë më 2008.

⁶Hasani, Enver, Cukalovic, Ivan, (2013), Komentari i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, faqe 618, Prishtinë: GIZ.

⁷Kuvendi i Kosovës, (2008), Transkripti i seancës plenare të datës 5 qershor 2008, faqe 5, Prishtinë: GZRKS, i qasshëm në http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/trans_s_2008_06_05_14_al.pdf (qasur në gusht, 2017)

⁸Republika e Kosovës, (2008), Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 100, Mocioni i Votëbesimit, paragrafi 1, faqe 39, Prishtinë: GZRKS, i qasshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702> (qasur në gusht, 2017).

⁹Kuvendi i Kosovës, (2017), Votimi elektronik i datës 10 maj për vetëm 1 pikë të rendit të ditës, Prishtinë: Kuvendi i Kosovës, i qasshëm në http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/voting/vot_1_2017_05_10_10_1.pdf (qasur në gusht, 2017)

¹⁰Presidenti i Republikës së Kosovës, (2017), Dekret Nr. DV-001-2017, Prishtinë: Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës.

Mbajtja e zgjedhjeve të parakohshme po ndikon negativisht në stabilitetin ekonomik të vendit. Programet qeveritare nuk po mund të realizohen por po mbesin në gjysmë, ndërkohë që qeveria e re po fillon implementimin e programit të saj qeverisë. Për më tepër, votuesit nuk janë aq të entuziazmuar për dalje aq të shpeshtë në zgjedhje, meqë dihet se ata votojnë për një qeveri e kuvend me mandat 4-vjeçar. Nëse gjithë kësaj i shtohen edhe lojrat e partive politike për interesa të ngushta partiake e personale, atëherë shtrohet pyetja nëse ia vlen që zgjedhjet të mbahen kaq shpesh, meqë shpeshherë rezultatet e zgjedhjeve nuk e ndryshojnë skenën politike për një kohë aq të shkurtë.

Një mënyrë për t'iu shmangur zgjedhjeve të parakohshme dhe të panevojshme do të ishte që mocioni i mosbesimit të bëhet i plotëfuqishëm vetëm nëse zgjidhet qeveria e re me kryeministër të ri, nga po i njëjti kuvend. Nëse një shumicë parlamentare ka mbledhur votat për ndëshkimin e një qeverie, e njëjta shumicë duhet edhe të arrijë kompromis për zgjedhjen e një qeverie të re. Nëse dështohet në zgjedhjen e qeverisë së re, atëherë qeveria e vjetër duhet ta vazhdojë punën e saj deri në përfundimin e rregullt të mandatit. Në këtë mënyrë do të shmangeshin zgjedhjet e panevojshme dhe kalkulimet e ngushta politike për interesa personale/individuale. Deputetët votohen për mandat katërvjeçar, andaj ata duhet të vendosin për shkarkimin e një qeverie dhe votimin e tjetrës brenda atyre katër viteve, dhe jo që vendin ta dërgojnë në zgjedhje të panevojshme dhe pa zgjidhje.

Për shkak të përfundimit të parakohshëm të legjislaturës së pestë dhe mungesës së vullnetit të partive politike, Kosova as me këto zgjedhje nuk arriti të ndërmarrë një reformë zgjedhore. Në diskursin e përgjithshëm, reforma parashikonte rishikimin e pragut zgjedhor, karakterit të mandatit të deputetit nëpërmjet shqyrtimit të opsionit të zonave, por edhe një sërë ndryshime tjera të cilat nuk ishin të mundshme. Mosrealizimi i reformës zgjedhore la të padiskutuara një mori problemesh që i kishin identifikuar paraprakisht nga organizatat e huaja, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe akterët e tjerë.

Zgjedhjet e përgjithshme parlamentare u karakterizuan me një realitet të ri ligjor, i cili ndikoi në kompozicionin e subjekteve garuese politike. Vendimi i vitit 2014 i Gjykatës Kushtetuese ishte vendimtar që partitë politike të kërkonin bashkëpunim, në formë të koalicioneve parazgjedhore! Në vitin 2014 Gjykata i dha dhënë të drejtë ekskluzive partisë ose koalicionit që i fiton zgjedhjet për të propozuar kandidatin për Kryetar të Kuvendit dhe që, së paku për herë të parë, të emërojë mandatarin për formimin e Qeverisë.¹¹ Ky realitet i ri, bashkë me atmosferën e bashkëpunimit ose mosbashkëpunimit mes të partive politike gjatë zgjedhjeve, nxiti LDK-në që të bëjë koalicion me Aleancën Kosova e Re (AKR) dhe me partinë e re ALTERNATIVA, dhe që në momentet e fundit PDK-ja të bënte koalicion me AAK-në dhe NISMA-n. VV hyri e vetme në zgjedhje, edhe pse paraprakisht u regjistrua si parti politike, me qëllim që të kishte mundësi ligjore për lidhjen e koalicioneve parazgjedhore.

Vendimi i vitit 2014 i Gjykatës kushtetuese hapi shumë debate e, njëkohësisht, edhe shumë dilema rreth ngjyrimin politik, marrë parasysh kohën kur u mor ky vendim. Vendimi dëshmoi se më shumë e bllokoi jetën institucionale se sa që bëri ndonjë zgjidhje, respektivisht, siç shprehet hulumtuesi nga KDI, Albert Krasniqi, ky interpretim i gjykatës kushtetuese “e ka çoroditur

¹¹Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, (2014), Aktvendim në Rastin Nr. K0103/14, fq. 23, Prishtinë

sistemin politik, ngase po prodhon bllokada të vazhdueshme”¹², në ndërkohë që Rasim Alija mendon se “vendimi i GJK e kufizon në masë të madhe vullnetin e lirë të deputetëve, duke i vendosur dhe bërë ata pjesë të pazareve politike, që qëllim në vetvete e kanë ndarjen e pushtetit”.¹³

Në kuptimin e bazës kushtetuese, por edhe të praktikave që i gjejmë kudo në botën demokratike vendimi i Gjykatës Kushtetuese gjithsesi se është i diskutueshëm. Dihet mirefilli se në secilen demokraci të avancuar sistemi funksionon mbi bazën e shumicës, dhe jo të të parit që nuk e ka shumicën, për të formuar institucionet e reja - natyrisht, duke mos e mohuar faktin që e drejta fillimisht i takon subjektit më të madh politik, që si i tillë ka dalë nga zgjedhjet.¹⁴ Sido që të jetë, dilema të tilla kanë nevojë të shtjellohen brenda një kornize të reformës zgjedhore, në mënyrë që reforma të mos kufizohet vetëm në ndryshimet ligjore por, nëse rezulton e pëlqyeshme, që të bëhen edhe ndryshime kushtetuese.

Është e pakuptimtë që të zgjedhurve të popullit t’iu imponohet votimi i një kandidati për Kryetar Kuvendi, megjithëse ka edhe mendime se “vendimi i Gjykatës Kushtetuese i vitit 2014 nuk mund të thuhet se e kufizon vullnetin e deputetëve, por e orienton atë, në mënyrë që vendimet të merren me lehtë. Po ashtu, pjesa për zgjedhjen e kryetarit të kuvendit është mëse e drejtë, dhe ajo nuk është në kundërshtim me praktikatat ndërkombëtare”¹⁵. Sipas Yll Buleshkajt, problemi “qëndron në atë se vendimi i jep autoritet dhe diskrecion një institucioni tjetër, Presidentit, që të vendos se nga cili grup parlamentar mund të vije kandidati i dytë”.¹⁶

Një tjetër karakteristikë e këtyre zgjedhjeve, që në masë të konsiderueshme po ashtu është pasojë e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, është shpallja e kandidaturave për Kryeministër. Subjektet kryesore politike nominuan liderë ose anëtarë të tyre për postin e kryeministrit duke i dhënë garës frymën e re të një sistemi mazhoritar, ndonëse i njëjti nuk është i tillë. Përfundimisht, vendimet e Gjykatës Kushtetuese me rastin e krizës së vitit 2014, ndikuan dukshëm në garën zgjedhore të 2017-s, nisur që nga kalkulimet para rrëzimit të Qeverisë e deri tek formimi i koalicioneve, kompozimi i listave të kandidatëve, etj.

Zgjedhjet e parakohshme spektrin politik në Kosovë e gjetën më të ndarë se kurrënjëherë më parë. Vota në bllok të gjerë e mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë nga të gjitha partitë politike në Kosovë krijoi një çarje jo vetëm mes të PDK-së dhe LDK-së, por edhe mes të LDK-së dhe partive tjera opozitare që më 2014 ishin bërë bashkë në bllokun VLAN (Vetëvendosje, LDK, AAK dhe NISMA). Tensioni ekzistonte edhe për shkak të dështimit në arritjen e konsensusit për temat si demarkacioni, ushtria, asociacioni i komunave me shumicë serbe, etj. Këto çështje publike të politikës dhe ndarja që ato kishin shkaktuar ndikuan shumë në atmosferën e përgjithshme zgjedhore.

Vullneti politik për hartimin e reformës zgjedhore vazhdon të mungojë edhe më tej. Nga njëra anë, partitë në pushtet tentimin për arritjen e një reforme zgjedhore e shohin si mënyrë për t’i pranuar

¹²Kosovo 2.0, Albert Krasniqi, Mësimet zgjedhore i morëm, tash ka ardhur koha t’i zbatojmë ato, e qasshme në <http://kosovotwopointzero.com/mesimet-zgjedhore-morem-tash-ka-ardhur-koha-ti-zbatojme-ato/> (qasur me 07/06/2018).

¹³Intervista 1: Hulumtues në D4D, (20.07.2018)

¹⁴Intervista 2: Ish anëtar i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, (23.07.2018)

¹⁵Intervista 3: Njohës i çështjeve zgjedhore, (06.07.2018).

¹⁶ Ibid.

zgjedhjet e parakohshme, e nga ana tjetër partitë opozitare janë më tepër interesuara që fillimisht t'i fitojnë zgjedhjet e pastaj të fillojnë me reformën zgjedhore.

Baza institucionale

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, është një organ i përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me proceset e zgjedhjeve dhe referendumeve, dhe që i shpallë rezultatet e tyre.¹⁷ Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve emërohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës, pasi të jenë propozuar nga partitë politike.

Mirëpo, nga shtatori i vitit 2017 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka mbetur pa mandat, dhe nuk ka mbajtur asnjë mbledhje. Kjo erdhi si rezultat i arsytimit të Zyrës së Presidentit se ende nuk i ka pranuar të gjitha propozimet nga partitë politike. Ky arsyetim supozon se të gjitha partitë duhet t'i dërgojnë emrat tek Presidenti, në mënyrë që pastaj të ketë një emërim grupor në KQZ. Kjo zvarritje e funksionalizimit të KQZ-së ndikon edhe në performancën e përgjithshme të zyrës, andaj edhe kjo gjë duhet të merret parasysh gjatë çfarëdo reforme në të ardhmen.

Zgjedhjet dhe administrimi i tyre

Në nëntor të vitit 2014, Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, znj. Valdete Daka theksoi se futja e teknologjisë informative në procesin zgjedhor do t'i ndihmonte shumë KQZ-së në procedimin e shpejtë të rezultateve. Sipas saj, reforma zgjedhore është e domosdoshme për adresimin e çështjeve të tilla. Megjithkëtë, reforma nuk ndodhi dhe znj. Daka, bashkë me KQZ-në, u përballën edhe njëherë me një bazë të pandryshuar ligjore dhe me afat të shkurtër për realizimin e zgjedhjeve.

Zgjedhjet e përgjithshme kësaj radhe ishin të tipit të parakohshëm. Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, këto zgjedhje ndodhin pas Dekretit Presidential për shpërndarjen e Kuvendit. Zgjedhjet e rregullta për Kuvend mbahen më së voni tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit, ndërsa në rast të shpërndarjes së Kuvendit jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë pas shpërndarjes.¹⁸ Në rastin e zgjedhjeve të rregullta, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mund t'i fillojë përgatitjet për aq kohë sa i nevojitet para mbajtjes së zgjedhjeve, ndërkohë që në rastin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme kjo kohë është tejet e limituar.

Në bazë të legjislacionit në fuqi, Kosova është territor zgjedhor njëzonal, dhe ajo ka një ndarje të ulëseve sipas sistemit proporcional, me njëzet ulëse të garantuara për komunitetet joshumicë dhe me kuotë preferenciale të garantuar prej 30% për femra.¹⁹ Sistemi përdorë lista të hapura me pesë kandidatë, me një renditje preferenciale për zgjedhjen si deputetët i Kuvendit të Kosovës. Mirëpo,

¹⁷Republika e Kosovës, (2008), Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 139, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Prishtinë: GZRKS.

¹⁸Republika e Kosovës, (2008), Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli IV, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Neni 66, paragrafi 2, Zgjedhja dhe Mandati, Prishtinë: GZRKS, e qasshme në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702> (qasur në gusht, 2017).

¹⁹Republika e Kosovës, (2008), Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Kreu XVIII, Sistemi Zgjedhor në Republikën e Kosovës, Neni 110, Dispozitat e Përgjithshme, faqe 47, i qasshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544> (qasur në gusht, 2017).

ne nuk do t'i diskutojmë përparësitë ose të metat e sistemit të përgjithshëm, por do të fokusohemi vetëm në administrimin e zgjedhjeve sipas rasteve të zgjedhjeve të fundit.

Administrimi i zgjedhjeve

Edhe pse në diskursin publik mundësia e zgjedhjeve të parakohshme ishte përmendur që nga zgjedhja e Presidentit të Kosovës, sukcesi i mocionit të mosbesimit ishte i pasigurt deri në datën e seancës. Kjo për shkak se Partia Demokratike e Kosovës e kishte lënë të paqartë qëndrimin e saj karshi mocionit të opozitës për mosbesimin ndaj Qeverisë.

Në këto zgjedhje nuk u pa pothuajse asnjë fushatë vetëdijesimi nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Për më tepër, një numër fare i vogël i organizatave të shoqërisë civile ndërmoi fushata vetëdijesimi për qytetarët. KQZ ka obligim ligjor që të zhvillojë aktivitete për informim publik.²⁰ Përkundër kësaj, një numër tejet i madh i votave ishin të pavlefshme




Figura 1. Statistika të përgjithshme të zgjedhjeve. Burimi: KQZ.²¹

Statistikat flasin për një numër shumë të madh të votave të pavlefshme. Në raportet përfundimtare, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve evidentoi se, nga totali i votave të siguruar 6.2% dolën të pavlefshme, një numër ky tejet i madh. Përveç kësaj, partitë politike dhe kandidatët e tyre u fokusuan ekskluzivisht në maksimalizimin e votës së tyre dhe pothuajse fare në edukimin e votuesve. Me gjithë kohën e shkurtër që KQZ kishte në dispozicion që nga data e shpërndarjes së

²⁰Republika e Kosovës, (2008), Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Kreu XVIII, Sistemi Zgjedhor në Republikën e Kosovës, Neni 110, Dispozitat e Përgjithshme, faqe 47, i qasshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544> (qasur në gusht, 2017).

²¹Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, (2017), Zgjedhjet e Përgjithshme 2017, Statistikat e Përgjithshme, Prishtinë: KQZ, e qasshme në http://www.kqz-ks.org/Uploads/Documents/1.%20Statistikat%20e%20C3%AABrgjithshme%20-%20General%20Statistics_lvzxcuouox.pdf (qasur në gusht, 2017).

Kuvendit, ajo viteve të fundit nuk organizuoi asnjë fushatë vetëdijësimi. Mungesa e aktiviteteve të KQZ-së në kohën kur nuk ka zgjedhje është shqetësuese.

Votat e pavlefshme - Edukimi i votuesve

Nëse numri i votave të pavlefshme është mbi 40,000 është, respektivisht mbi 6%, i bie që një numër tejet i madhi i votuesve nuk kanë arritur të marrin pjesë në vendimmarrje kolektive për zgjedhjen e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Sikurse tregon tabela e mëposhtme, numri i votave të pavlefshme ka shënuar rritje, po të krahasohet me tri palë zgjedhjet e fundit nacionale. Rritja është shënuar në përqindje, por edhe në vlera absolute.

Nëse votat e pavlefshme do të ishin parti politike garuese në minimum 7 deputetë!

Zgjedhjet per Kuvendin e Kosovës	2017	2014	2010
Nr i votuesve të Regjistruar	1,888,059	1,799,023	1,632,276
Nr i votuesve të cilët kanë votuar në secilin vendvotm	747,228	734,055	706,317
Nr i votuesve të cilët kanë votuar jashtë vendvotmit	32,501	32,779	33,001

Tabela 1. Statistikat e Zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës

Përkundër asaj që në të kaluarën vazhdimisht ka pasur programe për vetëdijësimin e votuesve dhe për mënyrën se si duhet votuar, të implementuar nga OJQ-të e ndryshme dhe nga institucionet zyrtare, mbetet fakti se investimi i qindra-mijëra ose edhe miliona eurove në këto 7 vitet e fundit nuk ka prodhuar asnjë efekt pozitiv në uljen e numrit të votave të pavlefshme. Nëse këto programe dhe këto mjete financiare të investuara nuk prodhuan efektin e duhur, atëherë shtrohet pyetja se çfarë duhet bërë ose ndryshuar që numri i votave të pavlefshme të bie në një përqindje të pranueshme. Për më tepër, rezultatet e fundit, qoftë në zgjedhjet nacionale apo në ato lokale, tregojnë se fituesi në disa raste është përcaktuar me një dallim prej disa dhjetra ose qindra votave, prandaj po të analizohet se sa vota janë të pavlefshme, mbetet e dyshimtë nëse vullneti i votuesve është ai që ka rezultuar.

Lloji i zgjedhjeve	Zgjedhjet lokale për Kuvend Komunal		Zgjedhjet lokale për Kryetar Komune	
	2017	2013	2017	2013
Nr i fletëvotimeve të përdorura	829,493	830,325	829,467	825,792
Nr i votuesve të cilët kanë votuar jashtë vendvotmit	17,812	18,882	22,260	23,592
Nr i fletëvotimeve të dëmtuara	2,247	1,466	1,441	1,080
Nr i fletëvotimeve të pavlefshme	66,151	70,782	13,814	15,512
Nr i fletëvotimeve të zbrazëta	5,500	12,775	7,889	8,248

Tabela 2. Statistikat e Zgjedhjeve Lokale

Në zgjedhjet lokale numri i votave të pavlefshme ende mbetet më i madh sesa në zgjedhjet nacionale, ndonëse tek zgjedhjet për kryetarë komunash numri i këtyre votave është shumë më i ulët. Kjo vetvetiu tregon se sistemi më i thjeshtë i votimit ka për rezultat një numër më të ulët votash të pavlefshme. Në shikim të parë, dhe pa u futur në ndonjë analizë empirike, por veçtm duke u bazuar në numrin e votave të pavlefshme dhe në krahasimin e tyre, si përfundim logjik del se numri i madh i votave të pavlefshme në zgjedhjet për Kuvend të Kosovës ose për kuvende komunale kryesisht ka të bëjë me sistemin zgjedhor në këto nivele, me mosdijen e votuesve për të votuar, si dhe me “fushatën agresive të kandidatëve”, e këtë të fundit e theksojnë edhe disa bashkëbisedues tanë. Mosinformimi i votuesve, respektivisht mosedukimi i tyre, rezultion si shkak i shumë votave të pavlefshme, gjë që e konfirmon edhe Kryetarja e Komisionit Qendror Zgjedhor, Valdete Daka, e cila këtë gjë e ndërlidhë edhe me numrin e madh të votuesve të rinj dhe me afatin e shkurtër për përgatitjen e zgjedhjeve të parakohshme.²²

Se votuesit gabojnë kur votojnë e konfirmon edhe Albert Krasniqi, i cili thekson se “auditimi që KQZ-ja ia ka bërë fletëvotimeve të pavlefshme në zgjedhjet parlamentare të vitit 2017, ka gjetur se 45.83% e fletëvotimeve të pavlefshme ndodhën për shkak se votuesit i kanë votuar vetëm kandidatët, por nuk kanë zgjedhur edhe subjektin politik”²³. Sipas Krasniqit, kjo vije si rezultat i “fushatës tejet agresive të kandidatëve, të cilët votuesve ua ofrojnë vetëm numrat e tyre, pa ua shpjeguar mirë se fillimisht duhet të shënohet edhe subjekti politik”.²⁴ Edhe Yll Buleshkaj thekson se te votat e pavlefshme “problem mund të jenë edhe fushatat individuale të kandidatëve, të cilët porosisin votuesit që të shënojnë numrin e tyre si kandidat, ndërkohë që mund të harrojnë të theksojnë edhe numrin e subjektit të cilit i përkasin”²⁵. Një numër i madh i votave shpallen të pavlefshme edhe për shkak të tentatimit të anëtarëve të Këshillave të Vendvotimit për t’i shtuar ose hequr votat kandidatëve të caktuar, pra nga përfshirja e tyre në manipulim të votave, në vend se në ruajtjen e votës së qytetarit, në përputhje me përgjegjësinë që kanë dhe me trajnimet ua ofron KQZ-ja.²⁶

Ky përfundim është logjik, po të shohim se të njëjtit votues në ditën e njëjtë në votim për kryetarë komunash, ku ka më tepër se dy kandidatë dhe kur duhet votuar vetëm njëri prej tyre, gabojnë shumë më pakë sesa kur votojnë më shumë kandidatë - në zgjedhjet nacionale ose lokale. Po t’i krahasojmë të tri palë zgjedhjet e viteve të fundit, vijmë në përfundimin se, për shkak të sistemit të komplikuar, më shumë se 3% e votuesve nuk dijnë si të votojnë në zgjedhjet nacionale, përderisa në zgjedhjet për kuvende lokale kjo përqindje shkon deri në 6%, ngase situata aty komplikohet edhe më tepër, si pasojë e sistemit të ndryshëm krahasuar me atë nacional ose me atë për kryetar.

²²Valdete Daka, e qasshme në <http://zeri.info/aktuale/147978/daka-votat-e-pavlefshme-pasoje-e-mosinformimit/> (qasur me 04/06/2018).

²³Kosovo 2.0, Albert Krasniqi, Mësimet zgjedhore i morëm, tash ka ardhur koha t’i zbatojmë ato, e qasshme në <http://kosovotwopointzero.com/mesimet-zgjedhore-morem-tash-ka-ardhur-koha-ti-zbatojme-ato/> (qasur me 07/06/2018).

²⁴Ibid.

²⁵Intervista 3: Njohës i çështjeve zgjedhore, (06.07.2018)

²⁶Ish-anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, (23.07.2018).

Lloji i zgjedhjeve	Zgjedhjet lokale për Kuvend Komunal		Zgjedhjet Nacionale		Zgjedhjet lokale për Kryetar Komune	
	2017	2013	2017	2014	2017	2013
Viti						
Nr i fletëvotimeve të përdorura	829,493	830,325	777,191	766,847	829,467	825,792
Nr i votuesve të cilët kanë votuar jashtë vendvotmit	17,812	18,882	32,501	32,779	22,260	23,592
Nr i fletëvotimeve të dëmtuara	2,247	1,466	1,746	1,899	1,441	1,080
Nr i fletëvotimeve të pavlefshme	66,151	70,782	42,554	30,725	13,814	15,512
Nr i fletëvotimeve të zbrazëta	5,500	12,775	6,553	4,842	7,889	8,248
% e votave të pavlefshme	7.97%	8.52%	5.48%	4.01%	1.67%	1.88%

Tabela 3. Statistikat e Zgjedhjeve të të dyja niveleve

Për të pasur të dhëna empirike, duhet bërë një analizë e të gjitha votave të pavlefshme, në mënyrë që të dihet saktësisht shkaku i kaq shumë votave të pavlefshme, por duke u bazuar gjithnjë në analizën krahasimore dhe në përfundimet logjike, se rezultati është sistem i komplikuar dhe i ndryshëm për të tri palë zgjedhjet, dhe se ai pastaj rezulton me një numër shumë të lartë të votave të pavlefshme. Mendojmë se thjeshtëzimi i mënyrës së votimit do të ishte hap i duhur drejt uljes së numrit të votave të pavlefshme, ngase edhe pas nëntë palë zgjedhjeve edukimi dhe milionat e shpenzuar për këtë qëllim nuk prodhuan rezultatet e pritura. Opsionet janë të shumta, duke filluar nga mbyllja e listës së të nominuarve e deri tek unifikimi i mënyrës së votimit, qoftë për kuvend nacional apo për atë lokal. Demokracia nuk ka çmim, andaj edhe nuk duhet lejuar që një numër aq i madh i zërit të qytetarëve të mos dëgjohet, vetëm për shkak se kemi krijuar një sistem të komplikuar votimi për ta.

Përkundër këtyre të dhënave, KQZ-ja ende nuk ka ndërmarrë ndonjë analizë të hollësishme e as hetim të votave të pavlefshme, për të parë nëse ka elemente të shkeljes së qëllimshme, ose nëse vërtet e gjithë kjo ka të bëjë me dhe është pasojë e mosedukimit të votuesve. Në bazë të informatave që kemi, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk ka ndërmarrë asnjë hetim të hollësishëm, dhe madje, përkundrazi, as nuk është përgatitur paraprakisht për adresimin e problemit të votave të pavlefshme dhe të edukimit të votuesve. Nga tabela e buxhetit për vitin 2017 shihet se KQZ-së - pa e llogaritur këtu buxhetin e veçantë për çdo palë zgjedhje - i janë dhënë edhe 70,000 euro për projekte të ndryshme.²⁷ Shumica e këtyre mjeteve kanë shkuar për projekte të furnizimit me pajisje dhe me softuerë të TI-së. Në të ardhmen do të duhej që, edhe në periudhat kur nuk është vit zgjedhor, KQZ të punojë në edukimin e votuesve mbi mënyrën e votimit dhe që t'i shfrytëzojë të dhënat e secilës votë të pavlefshme për identifikimin e problemeve.

As buxheti i ndarë për zgjedhje, në vlerë prej afër 5 milionë eurove, nuk është përdorur për pothuajse asnjë fushatë vetëdijësimi.

Shuma e planifikuar e mjeteve ka të bëjë me prodhimin e materialit zgjedhor; transportimin e materialit sensitiv dhe jo-sensitiv; trajnimin e Këshillave të

²⁷Ministria e Financave e Qeverisë së Republikës së Kosovës, (2017), Tabelat e Buxhetit për vitin 2017, Projektet Kapitale për Nivelin Qendror, faqe 99, Prishtinë: MF, e qasshme në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13230> (qasur në gusht, 2017)

Vendvotimit; pagesat për Komisionet Komunale të Zgjedhjeve; pagesat për anëtarët e Këshillave të Vendvotimit dhe për stafin tjetër ndihmës.²⁸

KQZ ka mundur t'i shfrytëzojë fushatat e vetëdijësimit dhe aktivitetet e tjera edukuese për zvogëlimin e numrit të votave të pavlefshme. Përveç me aktivitete të drejtpërdrejta, KQZ ka mundur që, përmes organizatave të shoqërisë civile dhe grupeve të tjera, ta delegojë një pjesë të madhe të punës në identifikimin e fushave ku mund të intervenohet me fushata vetëdijësimi dhe me aktivitete tjera që ishin pjesë edhe e zgjedhjeve të kaluara.

Votat me kusht

Një çështje tjetër me rëndësi që duhet trajtuar është edhe numri i madh i votave me kusht. Përkundër asaj se Kosova është një zonë zgjedhore dhe se të gjithë votuesit kanë kohë të mjaftueshme për të shikuar se ku duhet të votojnë, por edhe për të kërkuar që t'iu ndërrohet vendvotimi nëse ka nevojë, prapëseprapë 24,745 persona në zgjedhjet nacionale kanë votuar me kusht.

Nga numri i përgjithshëm i votave me kusht, vetëm 23,005 kanë qenë të vlefshme, 1,475 të pavlefshme dhe 177 kanë qenë të zbrazta. Këto të dhëna mbeten enigmatike, meqë në tabelën e paraqitur KQZ-ja nuk dihet se çfarë ka ndodhur me 88 fletëvotime që mungojnë. Rrjedhimisht, këtu hasen disa problem, por edhe ngriten dyshime, e para sepse nuk e dimë se sa prej 1,475 votave

Zgjedhjet nacionale 2017 Votat me kusht			
Të zbrazëta	Të pavlefshme	Të vlefshme	Gjithsej
177	1,475	23,005	24,745

Tabela 4. Votat me kusht në zgjedhjet nacionale të vitit 2017

ngjashme ka pasur edhe në zgjedhjet e kaluara, kur KQZ-ja mori vendim për fillimin e procedurave penale ndaj disa personave për tentim votimi të dyfishtë - një me kusht dhe një të rregullt. Kjo ka ndodhur në zgjedhjet e vitit 2013, mirëpo se çfarë ka ndodhur më pastaj dhe nëse KQZ-ja vërtet ka ndërmarrë hapa, nuk e kemi ndonjë raport.

Zgjedhjet për Kuvend Komunal 2017 Votat me kusht			
Të zbrazëta	Të pavlefshme	Të vlefshme	Gjithsej
26	1,126	9,881	11,065

Tabela 5. Votat me kusht në zgjedhjet lokale të vitit 2017

mundësi që një person i njëjtë të futej dy herë në vendvotime të ndryshme, kjo shkak i ngjyrës së sigurisë që i vendoset në dorë. Problem edhe më të madh paraqet mungesa e 88 fletëvotimeve, të

të pavlefshme janë shpallur si të tilla - nëse personi veç ka votuar njëherë në mënyrë të rregullt - meqë këtë nuk e tregojnë të dhënat e KQZ-së. Nëse ka raste të tilla, atëherë duhen filluar procedurat penale ndaj personave që kanë tentuar të votojnë dy herë. Raste të

Në ndërkohë edhe vetë KQZ-ja e konfirmon se ka pasur tentim të votimit të dyfishtë, në një rast në komunën e Istogut.²⁹ Këtu duhen hetuar edhe komisionerët, sepse po ta kryenin punën si duhet nuk do të kishte

²⁸Ueb faqja zyrtare e KQZ-së, (2017), Njoftim: KQZ-ja fillon përgatitjet për organizimin e Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, i qashëm në <http://www.kqz-ks.org/sq/lajme/Details/298> (qasur në gusht, 2017).

²⁹KQZ:Ja pse u konfirmuan dhe u refuzuan votat me kusht e postë, i qashëm në <https://infoglobi.com/kqz-ja-pse-u-konfirmuan-dhe-refuzuan-votat-me-kusht-e-poste/> (qasur në qershor, 2018).

cilat nuk shfaqen fare në tabelën e KQZ-së. Nëse këto fletëvotime mungojnë, atëherë duhet filluar procedurë penale ndaj 88 personave, nën dyshimin e manipulimit të zgjedhjeve. Mungesa e fletëvotimeve në kutitë e votimit paraqet tjetër problem serioz, sepse kjo gjë lidhet drejtpërsëdrejti me të ashtuquajturin “trenin bullgar”.

Se votimi me kusht shërben si mundësi manipulimi e konfirmon edhe Albert Krasniqi, i cili thekson se, votimi me kusht edhe “e vonon procesin e shpalljes së rezultateve”.³⁰Fletëvotimi i vjedhur mund të përdoret për të blerë votën dhe për t’u siguruar se vota e blerë do t’i shkojë “kandidatit të duhur”. Komunitat që prijnë me mungesë fletëvotimesh të hedhura me kusht janë Gjakova me 15, Kaçaniku me 11, Prishtina me 8, dhe Suhareka e Vushtrria me nga 6.

AS këtu s’kemi të dhëna sesa nga këta votues kanë tenuar të votojnë dy herë, e as për atë se çfarë ka ndodhur me këto 32 fletëvotime. Komunitat që prijnë për numrin e fletëvotimeve me kusht që mungojnë janë Prishtina me 11, Istogu me 6 dhe Gjakova me 3.

Për sa i përket votave për kryetarë komunash, janë gjithsej 236 vota të pavlefshme dhe mungojnë 53 fletëvotime. Duke I pasur parasyshë rezultatet e ngushta në garën për kryetar në shumë komuna, mungesa e fletëvotimeve duhet të jetë një sinjal i kuq, se duhet ndërmerren masa urgjente ndaj kësaj dukurie.

Zgjedhjet për Kryetar Komune 2017 Votat me kusht			
Të zbrazëta	Të pavlefshme	Të vlefshme	Gjithsej
129	236	10,649	11,067

Tabela 6. Votat me kusht në zgjedhjet për Kryetar Komune e të vitit 2017

Komunitat që prijnë me mungesë të fletëvotimeve nga votat me kusht në votimin për kryetar komune janë Prishtina me 14, Istogu me 6 dhe Gjakova me 5. Auditimi i votave me kusht duhet gjithsesi të bëhet, dhe rezultatet duhet të bëhen transparente, ndërkohë që të

gjithë ata që e kanë keqpërdorur këtë mundësi duhen ndjekur penalisht. E kaluara ka dëshmuar se sa herë janë ndërmarrë masa penale ndaj komisionerëve abuzues, të tjerët në të ardhmen kanë qenë shumë më të kujdesshëm.

Sipas Yll Buleshkajt, “duke pasur parasysh se lista e votuesve të Kosovës është ende larg nga të qenurit perfekte” dhe “përderisa në zgjedhjet lokale votat me kusht ndoshta edhe do të mund të hiqeshin, për zgjedhjet kombëtare ky opsion nuk duhet të konsiderohet për një periudhë afatmesme (deri në 10 vjet)”³¹. Edhe Enis Halimi mendon se me votën me kusht duhet vazhduar, derisa të mos kemi një sistem të integruar të adresave, si dhe një reflektim të këtij sistemi për alokimin e saktë të votuesve dhe një listë të saktë të votuesve³², në ndërkohë që Albert Krasniqi mendon se, “aplikimi i mëtejme i votimit me kusht është i panevojshëm”.³³ Rasim Alija ndërkaq mendon se, “ideale do të ishte që në zgjedhjet lokale votimi me kusht të hiqej komplet”, ndonëse nënvizon se, “megjithatë, opsioni i heqjes së votimit me kusht për zgjedhjet lokale duhet të

³⁰Kosovo 2.0, Albert Krasniqi, Mësimet zgjedhore i morëm, tash ka ardhur koha t’i zbatojmë ato, e qasshme në <http://kosovotwopointzero.com/mesimet-zgjedhore-morem-tash-ka-ardhur-koha-ti-zbatojme-ato/> (qasur me 07/06/2018).

³¹Intervista 3: Njohës i çështjeve zgjedhore, (06.07.2018)

³²Intervista 4: Zyrtar i lartë në KQZ, (09.07.2018)

³³Kosovo 2.0, Albert Krasniqi, Mësimet zgjedhore i morëm, tash ka ardhur koha t’i zbatojmë ato, e qasshme në <http://kosovotwopointzero.com/mesimet-zgjedhore-morem-tash-ka-ardhur-koha-ti-zbatojme-ato/> (qasur me 07/06/2018).

analizohet edhe në frymën e të drejtave të njeriut, përkatësisht në lirinë dhe mundësinë që secili qytetar të mund ta ushtrojë të drejtën e tij për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur”.³⁴

Punimi sugjeron se vota me kusht duhet të hiqet plotësisht. Mendojmë se problemet që sjell ky opsion janë shumë më të mëdha sesa të përfitimet nga ai. Koha e mjaftueshme për të parë se ku e ke vendvotimin, koha e mjaftueshme për ndërrimin e vendvotimit, si dhe territori i vogël i Kosovës për të shkuar e votuar kudo që e ke vendvotimin, janë argumente të mjaftueshme për heqjen e mundësisë së votimit me kusht, meqenëse edhe mundësia e manipulimit të kësaj vote është shumë e madhe, nga njëra anë, dhe votat me kusht ndikojnë në vonimin e shpalljes së rezultateve dhe kjo detyrimisht ndikon në ngritjen e tensioneve pas zgjedhore, nga ana tjetër.

Edhe tek votat me kusht numri votave të pavlefshme korrespondon me votat e pavlefshme tek votimi i rregullt. Në zgjedhjet nacionale, votat e pavlefshme me kusht janë 6%, për kuvend komunal ato arrijnë në 10%, përderisa në ato për kryetarë komunash të pavlefshme janë rreth 2%. Edhe njëherë, në bazë të analizës krahasimore vijmë në përfundimin se sistemi i thjeshtë i votimit për kryetarë komunash prodhon një numër më të vogël të votave të pavlefshme, përderisa tek votimi për kuvende komunale dhe atë nacional numri i tyre është tepër i madh.

Votat me postë

Zgjedhjet nacionale 2017 votat me postë			
Të zbrazëta	Të pavlefshme	Të vlefshme	Gjithsej
12	113	5,076	5,201

Tabela 7. *Votat me postë për zgjedhjet nacionale 2017*

votave me postë janë vota të falsifikuara nga grupet e organizuara³⁵. Sipas po të njëjtit burim, votat me postë nga Serbia janë manipuluar në masë të madhe, ndonëse në fund kaluan si të vlefshme.

Zgjedhjet për Kryetar Komune 2017 votat me postë			
Të zbrazëta	Të pavlefshme	Të vlefshme	Gjithsej
2	6	5,440	6,751

Tabela 8. *Votat me postë për Kryetar Komune 2017*

nacionale 2017 përmes postës kanë votuar 5,201 persona, ndërkaq të vlefshme kanë qenë

Votat me postë vazhdimisht kanë qenë temë diskutimi, shkaku i mundësisë së keqpërdorimit. Zgjedhjet e fundit edhe njëherë dëshmuar se këto vota janë keqpërdorur me të madhe. Me mijëra vota me postë janë anuluar shkaku i keqpërdorimeve. Sipas burimeve nga KQZ-ja, vlerësohet se rreth gjysma e

Numri i madh i votuesve kosovarë në diasporë dhe numri i vogël i atyre që votojnë përmes postës është një arsye më tepër për të rikonsideruar këtë mënyrë votimi. Përveç vonesave dhe investimeve në këtë mënyrë të votimit, pjesëmarrja e votuesve të tillë në vazhdimësi ka qenë shumë e ulët. Sipas KQZ-s, në zgjedhjet

³⁴Intervista 1: Hulumtues në D4D, (20.07.2018).

³⁵Intervista 1: Hulumtues në D4D, (20.07.2018).

5,076 fletëvotime. Në zgjedhjet për kuvende lokale kanë votuar 6,570 persona, ndërkaq të vlefshme kanë qenë 5,030 fletëvotime.

Në zgjedhjet për kryetarë komunash kanë votuar 6,751 persona, të vlefshme kanë qenë 5,440 dhe janë refuzuar (është ky supozim, ngase kjo nuk shpjegohet në tabelën e paraqitur nga KQZ-ja) 1,303 fletëvotime. Këtu duhet cekur se me mijëra aplikacione janë refuzuar, dhe kjo nuk figurojnë fare në tabelat e paraqitura në faqen zyrtare të KQZ-së. Kur të kihet parasysh se numri i votuesve nga diaspora llogaritet të jetë mbi 500,000 votues, atëherë rezulton se të drejtën e votimit përmes postës e shfrytëzon një numër shumë i vogël i tyre.

Për sa i përket procesit të votimit përmes postës, si proces i ndërtuar ekskluzivisht për shtetasit e Kosovës me qendrim jasht vendit, mendojmë se procesi duhet ndryshuar, ngase si i tillë është i komplikuar dhe i vështirë. Ndryshimi duhet të konsistojë në gjetjen e formave të tjera, më të lehta të votimit për shtetasit tonë jashtë Kosovës. Për shembull, një formë e cila zbatohet gjerësisht në shtetet e ndryshme, është organizimi i votimit në përfaqësitë diplomatike.³⁶Këto modele ende nuk janë diskutuar sa duhet në diskursin publik.

Albert Krasniqi mendon se votimi me postë duhet zëvendësuar me “votimin personal, që organizohet në misionet diplomatike”³⁷. Të njëjtën mendim e ka edhe Enis Halimi, ndonëse shton se, për votimin me postë në zgjedhjet komunale “duhet të shikohet mundësia që të hiqet fare”³⁸, përderisa Yll Buleshkaj thekson se “votimi me postë në nivel nacional duhet të mbetet, përderisa votimi për zgjedhjet komunale edhe mund të hiqet”³⁹. Rasim Alija ndërkaq mendon se “në reformën zgjedhore, si alternativë për zëvendësimin e votës me postë, duhet të analizohet opsioni i votimit në ambasadat e Kosovës”.⁴⁰

Dyshimet për ekzistimin e votave me postë kanë ekzistuar në vazhdimësi, ngase edhe në zgjedhjet e mëhershme vinin vota me postë të nënshkuara nga e njëjta dorë, gjë që ishte dëshmi e mjaftueshme se këto vota ishin keqpërdorur. Për t’i larguar të gjitha këto dyshime, dhe për të pasur një proces sa më transparent, votimi me postë duhet hequr dhe duhet mundësuar votimi fizik nëpër ambasadat dhe konsullatat e Republikës së Kosovës. Kjo mundësi duhet implemtnuar në zgjedhjet nacionale, përderisa në zgjedhjet lokale nuk duhet lejuar fare votimi i personave që nuk kanë jetuar në komunën përkatëse, të paktën në 6 muajt e fundit. Është e pakuptimtë që në zgjedhjet lokale të kenë të drejtë votimi personat që kurrë nuk kanë jetuar në Kosovë, vetëm e vetëm për shkak se posedojnë dokumente kosovare. Çështjet lokale mbeten lokale, anadaj edhe iu takon banorëve të komunës përkatëse të zgjedhin se kush duhet t’i udhëheqë në katër vitet e ardhshme.

³⁶Intervista 2: Ish anëtar i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, (23.07.2018)

³⁷Kosovo 2.0, Albert Krasniqi, Mësimet zgjedhore i morëm, tash ka ardhur koha t’i zbatojmë ato, e qasshme në <http://kosovotwopointzero.com/mesimet-zgjedhore-morem-tash-ka-ardhur-koha-ti-zbatojme-ato/> qasur me 07/06/2018).

³⁸Intervista 2: Ish-anëtar i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, (23.07.2018)

³⁹Intervista 2: Ish-anëtar i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, (23.07.2018)

⁴⁰Intervista 1: Hulumtues në D4D, (20.07.2018).

Administrimi i rezultatit të zgjedhjeve

Një problem tejet i madh që është vërejtur në këto zgjedhje është vonesa e shpalljes së rezultateve, sidomos e shpalljes së rezultateve përfundimtare. Që nga dita e mbajtjes së zgjedhjeve, më 11 qershor, rezultatet nuk u certifikuan për plotë 27 ditë. Pra, u deshën plot një muaj për certifikim të rezultatit zgjedhor. Kjo për shkak të procedurave ligjore të ankimimit të rezultateve, duke filluar që nga shpallja e rezultateve preliminare, atyre përfundimtare e deri tek certifikimi i tyre. E njëjta situatë ndodhi edhe në zgjedhjet lokale, të cilat u mbajtën disa muaj më vonë. Edhe në zgjedhjet lokale procedurat e parapara ligjore për ankimim ndikojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë në shpalljen e rezultatit përfundimtar.

Ankesat e shumta e vonuan procesin e numërimit të votave. Kjo ngase, sipas rregulloreve aktuale ligjore, rezultatet e para ose preliminare jepen pas të dhënave të numërimit në vendvotime. Tutje kutitë e votimit barten në Qendrën e Numërimit, ku bëhet verifikimi i të dhënave dhe, nëse ka nevojë, rinumërimi i tyre. Akti i rinumërimit bëhet vetëm me urdhër të KQZ-së dhe atë nëse Komisioni për Ankesa dhe Parashtrësia vlerëson se ka pasur parregullësi, ose nëse nuk ka përputhje të të dhënave. Këtu, ndonëse Ligji⁴¹ e kufizon KQZ-në, kjo fundit ka mundur të shqyrtojë alternativa tjera, si për shembull të urdhërojë rinumërimin në mënyrë automatike të secilës votë në Qendrën e Numërimit.

Pas rinumërimit të vetëm 117 kutive të votimit në zgjedhjet e fundit nacionale, tre kandidatë arritën të futen në Kuvend të Kosovës pas heqjes nga lista e deputetëve të tre kandidatë tjerë të cilët para rinumërimit konsiderohej se i kishin fituar vota të mjaftueshme.⁴² Ndërkaq, gjatë zgjedhjeve të fundit lokale, pas rinumërimit të 440 vendotimeve u bënë 14 ndryshime në listën e asambleistëve nëpër komunat përkatëse, përfshirë këtu edhe vetë ndërrimin e numrit të votave të kandidatit për kryetar të Istogut.⁴³

Vota është e fshehtë, por jo edhe akti i votimit! Pra, përse të mos publikohet lista se kush ka votuar?!

Duke e marrë parasysh edhe mundësinë që nëpërmjet rinumërimit votat ndryshohen qoftë edhe për vetëm një kandidat, atëherë kjo nënkupton një arsye e mjaftueshme që tash e tutje të bëhet numërimi i dyfishtë, përkatësisht të bëhet rinumërimi i menjëhershëm i të gjitha votave. Kjo do të ishte një përpjekje shtesë që vullneti i votuesve të reflektojë besnikërisht në rezultatet përfundimtare. Përndryshe, rezultatet përfundimtare pa një rinumërim të përgjithshëm të votave gjithmonë do të jenë diskutabile. E dyta, rinumërimi i përgjithshëm i votave do të mundësonte uljen e numrit të ankesave, të cilat e vonojnë procesin e numërimit të votave. E treta, rinumërimi i menjëhershëm i të gjitha votave do të siguronte një proces më të shpejtë dhe, njëkohësisht, edhe do të rriste përgjegjësinë e komisionarëve në vendvotime. Nëse të gjitha kutitë do të rinumëroheshin brenda një afati prej 3-4 ditësh nga data e përfundimit të zgjedhjeve, KQZ do të ishte e gasthme që maksimalisht brenda një jave ta certifikonte rezultatit e zgjedhjeve, andaj edhe rezultatet përfundimtare do të kishin shumë më pak hapësirë për kontestim.

Normalisht, kjo do të kërkonte që KQZ të angazhojë staf shtesë për një periudhë të shkurtër, por do ta përshpejtonte shumë procesin. Njëkohësisht, nëse komisionarët do të kishin informacion se

⁴¹Republika e Kosovës, (2008), Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i qasshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544> (qasur në gusht, 2017).

⁴²Rinumërimi i votave ndryshon listën e deputetëve (FOTO), <http://klankosova.tv/rinumerimi-i-votave-ndryshon-listen-e-deputeteve-foto/>

⁴³Rinumërimi i votave në Kosovë, përmbysset Istogu <http://top-channel.tv/2017/11/24/rinumerimi-i-votave-ne-kosove-permbysset-istogu/>

kutia e tyre gjithsesi do të rinumërohej, do të ishin shumë më të kujdesshëm gjatë mbushjes së formularit dhe raportimit të rezulttit.

Përveç pjesës së administrimit të rezultateve, KQZ një pjesë të mirë të punës së vetë duhet ta bëjë edhe në adresimin e mungesës së transparencës. Më saktësisht, KQZ ka mundur të përdorte shumë më tepër transparencën, si instrument për parandalimin e shkeljeve. Deri më tani, KQZ nuk ka bërë publikimin e emrave të komisionarëve për të cilët është vërtetuar se kanë bërë shkelje. Kjo formë e presionit publik është efektive për parandalimin e rasteve të keqpërdorimit të votës në të ardhmen. Një masë tjetër e transparencës, që do të mund të adresonte një pjesë të madhe të akuzave për keqpërdorime në ditën e zgjedhjeve, është publikimi i listës së votuesve që kanë votuar. Kjo do të identifikonte saktësisht personat e vdekur, ose jorezidentë, të cilët po votojnë, rrjedhimisht, ky do të ishte një presion shtesë mbi komisionarët për të mos bërë veprime të tilla.

Kandidatët dhe subjektet

Në zgjedhjet e përgjithshme katër kryetarë komunash ishin kandidatë për deputetë. Tre nga ta e fituan mandatin e deputetit. Nga kjo katërshe, tre do të garojnë sërish për kryetarë komunash. Një praktikë e tillë, edhe pse është e ligjshme, s'mund të konsiderohet legjitime.

Mandatet e kryetarëve të komunave janë katërvjeçare. Sipas sistemit tonë politik, në bazë të Marrëveshjes Kornizë të Ahtisarit dhe aplikimit të modelit të decentralizimit, kryetarët e komunave de facto janë liderët lokalë. Ata zgjidhën drejtpërsëdrejti dhe ushtrojnë kompetenca të zgjeruara ekzekutive. Edhe pse Kushtetuta askund nuk e ndalon kandidimin, madje as ushtrimin e detyrës së Kryetarit të Komunës, kjo e fundit është mbuluar deri diku me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale.

Menjëherë pas zgjedhjes së tyre, kryetarët e komunave ndërpresin çdo kontratë apo lidhje që kanë, e cila mund ta vë në pikëpyetje aftësinë e tyre për kryerjen e përgjegjësive të tyre në mënyrë të drejtë dhe të paanshme.⁴⁴

Edhe pse ligjërisht e kanë të ndaluar, pjesëmarrja e kryetarëve të komunave në fushatën zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme, ngase në praktikë i ata e ndërprejnë ushtrimin e mirëfilltë të detyrës së kryetarit. Rrjedhimisht, pjesëmarrja e kryetarëve të komunave në zgjedhjet komunale e dëmton qeverisjen komunale në atë komunë. Gjithashtu, shkollat janë edhe qendra votimi. Drejtorët e shkollave i emëron drejtoria komunale, e ndikuar drejtpërdrejtë nga Kryetari i Komunës. Rrjedhimisht, kandidimi i kryetarëve të komunave në zgjedhjet e përgjithshme mund të trajtohet edhe nga këndi i konfliktit të interesit të udhëheqësve të qendrave të numërimit. Sidoqoftë, çështja e kandidimit të kryetarëve të komunave në zgjedhjet qendrore dhe e deputetëve për kryetarë komunash mund të jetë pjesë e reformës zgjedhore, në mënyrë që këta të fundit të detyriohen që, në momentin që kandidojnë, të heqin dorë nga posti i parë. Nga aspekti kushtetues, kjo gjë është vështirë e realizueshme, edhe pse do të ishte legjitime të bëhej.

Ecuria e zgjedhjeve nuk ishte e njëjtë në të gjitha komunat e Kosovës. Procesi zgjedhor ndryshonte në mënyrë të konsiderueshme në komunat me shumicë shqiptare të Kosovës krahasuar me ato me shumicë serbe.

⁴⁴Republika e Kosovës, (2008), Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Neni 59, Konfliktet e Interesit, Prishtinë: GZRKS, e qasshme në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530> (qasur në gusht, 2017)

Në komunat e Kosovës me shumicë shqiptare, zgjedhjet ishin vërtet konkurruese dhe ambienti i fushatës ishte i qetë, duke lejuar që një numër i madh i kandidatëve t'i komunikojnë lirisht mesazhet e tyre ndaj elektoratit. Në anën tjetër, fushatat në shumë lokalitete serbe u dëmtuan nga kërcënimet, të cilat veçanërisht kishin në shënjestër partitë serbe që nuk i takonin Listës Serbe.⁴⁵

Kërcënimet drejt partive dhe kandidatëve serbë, që nuk i takonin Listës Serbe, ndikuan shumë në dëmtimin e imazhit të zgjedhjeve. Këto elemente të zgjedhjeve u identifikuan edhe në raportet ndërkombëtare, e veçanërisht në ato të Misionit Vëzhgues të Bashkimit Evropian. Kërcënim ka qenë edhe presioni ndaj kandidatëve të ndryshëm për t'u tërhequr nga gara, por edhe incidentet shpesh të dhunshme në Leposaviq, të cilat konkretisht për cak kishin partitë politike dhe kandidatët që kontestojnë dominimin e Listës Serbe.⁴⁶ Të gjitha këto, bënë që procesi zgjedhor në komunat me shumicë serbe të mos konsiderohet i lirë dhe demokratik.

Përfundime me Rekomandime

Mbajtja e zgjedhjeve të parakohshme po ndikon negativisht në stabilitetin politik dhe ekonomik të vendit. Krijimi i institucioneve të reja po merr kohë, ndërkohë që nga momenti i shpalljes së zgjedhjeve e deri të konstituimi i institucioneve të reja po humben muaj të vlefshëm. Sidomos tani, kur Kosova po ka nevojë për një ambient stabil politik për përmbushjen e kritereve të shumta për integrim evropian, zgjedhjet e parakohshme po i ndërpresin këto procese e në disa raste edhe po i kthejnë ato prapa.

Ky punim i adresoi disa nga aspektet e sistemit zgjedhor, për të cilat konsensusi politik do të arrihej lehtë. Po të përmirësoheshin këto aspekte, procesi zgjedhor do të rezultonte më i suksesshëm dhe nuk do të humbej kohë që Kosova të arrijë ta realizojë një reformë të thellë zgjedhore. Ajo që është tejet e rëndësishme në tërë procesin zgjedhor të një vendi është pikërisht siguria që duhet ta ketë qytetari, se vota e tij, përkatësisht përmbushja e obligimit të tij si qytetar i vendit, do të delegohet paanshëm. Për këtë arsye, duke qenë të vetëdijshëm mbi problemet kryesore të sistemit, mungesa e një konsensusi rreth elementeve thelbësore të reformës zgjedhore nuk duhet ta pengojë përmirësimin e procesit zgjedhor, përmes një qasjeje nga poshtë-lart. Veprimet e rekomanduara nuk e prekin thelbin e sistemit zgjedhor, andaj mendojmë se edhe pajtueshmëria e partive politike për këto ndryshime do të jetë lehtë e arritshme.

⁴⁵Misioni Vëzhgues i Bashkimit Evropian, (2017), Raporti Final i Zgjedhjeve të Përgjithshme të Kosovës të vitit 2017, i qasshëm në https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/final_report_com_kosovo_june_2017.pdf (qasur në korrik, 2018).

⁴⁶Misioni Vëzhgues i Bashkimit Evropian, (2017), Raporti Final i Zgjedhjeve të Përgjithshme të Kosovës të vitit 2017, i qasshëm në https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/final_report_com_kosovo_june_2017.pdf (qasur në korrik, 2018).

Për të arritjen e këtyre përmisimeve në kuadër të procesit dhe adminsitrimt të zgjedhjeve, duhet të ndërmerren të paktën këta hapa:

- ✓ **Të konsiderohet rinumërimi i votave me automatizëm në Qendrën e Numrimit të Votave. Ky proces:**
 - Ulë numrin e ankesave;
 - Përshpejton procesin dhe shpalljen e rezultateve;
 - Zvogëlon mundësinë e manipulimit të votave për kandidatët brenda llojit;

- ✓ **Të hiqet mundësia e votimit me kusht:**
 - Ulë mundësinë e manipulimit, përfshirë këtu edhe manipulimin përmes të të ashtuquajturit “treni bullgar”;
 - Përshpejton procesin e numërimit dhe shpalljen e rezultateve përfundimtare;

- ✓ **Të hiqet votimi me postë:**
 - Mënjanohet mundësia e manipulimit të votave me postë, siç është dëshmuar në të kaluarën;
 - Mundësohet votimi fizik në zgjedhjet nacionale; ndërkaq zgjedhjet lokale votimi me postë duhet eliminuar tërësisht;
 - Përshpejtohet procesi i numërimit dhe i shpalljes së rezultateve përfundimtare;

Ky raport është mbështetur nga:

Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim (SDC) dhe nga Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe i menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e Grupit për Hulumtim të Politikave në Ballkan dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së

Dhe

Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë



Norwegian Embassy

Grupi për Ballkan për Hulumtimin e Politikave është organizatë (think tank institute) jo profitabile, e pavarur, rajonale, me seli në Prishtinë, Kosovë. Ne ofrojmë analiza dhe rekomandime mbi një numër çështjesh rreth politikave të shtet-ndërtimit, konsolidimit institucional e demokratik; integritit të minoriteteve, dhe marrëdhënieve ndërshtetërore; si dhe integritit evropian dhe reformave politike. Ekipi i Grupit për Ballkan ka përvojë pesëmbëdhjetëvjeçare në hartimin e raporteve rreth politikave zhvillimore, të menduarit në mënyrë strategjike, dhe avokimit tek qeveritë, shtetet dhe organizatat ndërkombëtare, si dhe ato jo-fitim prurëse.

Thelbi i punës sonë qëndron në raportimet tona rigorozë, të detajuara, të paanshme dhe gjithmonë të bazuara në hulumtimet tona nga terreni e gjeneza e zhvillimeve. Ne shkojmë përtej qëndrimeve të etabluara dhe punojmë që të bëjmë ndryshime përmes rekomandimeve kreative, të realizueshme dhe të matshme, duke kontribuar që shtetet tona të zhvillojnë shoqëri demokratike, të qëndrueshme dhe të suksesshme bazuar në sundimin e ligjit.

Grupi Ballkanik ka dizajnuar edhe instrumente të reja që të arrijë këtë ndryshim, siç janë Dialogu Politik, Forumi Politik (Instrumenti i avokimit të nivelit të lartë) dhe Forumi Ndër-Kufitar i Bashkëpunimit të Shoqërisë Civile.

Për më shumë, vizitoni web-faqen tonë ose na kontaktoni në office@balkansgroup.org



Norwegian Embassy



MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK
DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION